

KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT NË DEGËT ARKITEKTURË, URBANISTIKË DHE BACHELOR NË ARKITEKTURË INTERIERI DHE DIZAJN PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Për vitin akademik 2019-2020 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”* dhe në Vendimin Nr. 1 datë 17.01.2019 të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, ka vendosur që përzgjedhja e kandidatëve fitues në studimet e integruara të ciklit të dytë për degët Arkitekturë dhe Urbanistikë si dhe Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn të realizohen mbi bazën e **vlerësimit të Shkollës së Mesme** dhe **Testit të Pranimit** mbi bazën e formulës:

$$0.6 * Mes_{VKM} * K_{Koeff. Shkollës} * 1000 + 0.4 * T_{Testi} * 100$$

ku:

Mes_{VKM}, do të quajmë notën mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2019-2020, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”*.

K_{Koeff. Shkollës}, do të quajmë koeficientet e shkollave të mesme.

T_{Testi}, do të quajmë rezultatin e testit që do të organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës i cili synon vlerësimin e njohurive në degët specifike të studimit, i përbërë nga katër komponent, si më poshtë:

Test i arsytimit logjik	25% e T _{Testi} (25 pike)
Test i kulturës së përgjithshme	25% e T _{Testi} (25 pike)
Test i historisë dhe historisë së arkitekturës	25% e T _{Testi} (25 pike)
Test i komunikimit grafik	25% e T _{Testi} (25 pike)

Testimi i kandidateve do të jetë i organizuar në një ditë dhe do të zgjasë 2-3(tre) orë. Testi i pranimit do të përmbajë pyetje dhe përgjigjet e pyetjeve do të jenë me përzgjedhjen e alternativës së saktë, në mënyrë që të mundësojë korrigjimin elektronik.

TESTI I PRANIMIT

Testi i pranimit në programet e integruara të studimit në degën Arkitekturë dhe Urbanistikë dhe programin e studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës u drejtohet të gjithë studentëve të cilët janë kandidatë potencialë për të ndjekur studimet pranë këtij institucioni.

MODEL ORIENTUES I TESTIT

I. Test i arsyetimit logjik

Testi i arsyetimit logjik ka 25% të pyetjeve të përgjithshme.

Kandidati potencial, i cili do të ndjekë studimet në degët e Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të reflektojë një seri cilësish të lidhura me arsyetimin logjik të tij. Pyetjet do të merren me raste ose probleme, të cilat do të bazohen në tekste të eseve me një natyrë shkencore apo me një natyrë abstrakte, zgjidhja e së cilës kërkon adoptimin e formave të ndryshme të arsyetimit logjik.

Në fushën e arsyetimit logjik, tentohet të evidentohen ata kandidatë që shfaqin kapacitet analitik racional, si dhe intuitë në perceptimin 2-dimensional e 3-dimensional. Të dyja format e dijes (empirike apo inteligjencë natyrore) ndikojnë në performancën e kandidatëve, por një pjesë e mirë e pyetjeve fokusohen në aftësinë e tyre për të analizuar në një kohë relativisht të shkurtër. Në një hark të kufizuar kohor, kandidatët duhet të kuptojnë kërkesat e problemit të pozuar, të analizojnë e të japin alternativën e duhur.

Testi i arsyetimit logjik do të përmbajë tri tipologji kryesore të ushtrimeve të mundshme:

1. Ushtrime të bazuara mbi problema të arsyetimit logjik.

Shembull 1

1-1 Nëse:

- Të gjithë matematicienët janë të saktë
- Mateo është i pasionuar pas gatimit
- Të gjithë të pasionuarit pas gatimit janë të saktë

Cili nga pohimet e mëposhtëm është plotësisht i vërtetë?


- | | |
|---|-----------------------|
| A) Mateo është i saktë | ☐ |
| B) Kush është i pasionuar pas gatimit nuk mund të jetë matematician | ☐ |
| C) Mateo është matematician | ☐ |
| D) Të gjithë matematicienët janë të pasionuar pas gatimit | ☐ |
| E) Të gjithë të saktët janë të pasionuar pas gatimit | ☐ |

2. Ushtrime që kombinojnë arsyetimin logjik dhe intuitën pamore.

Shembull 2

2-1. Bazuar në logjiken mbi të cilën ndërtohet sekuenca, përcaktoni figurën që plotëson serinë:

- A) Figura 2
- B) Figura 3
- C) Figura 1
- D) Figura 4
- E) Figura 5



3. Ushtrime që kontrollojnë aftësitë e të kuptuarit përmes tekstit.

Shembull 3

3-1. Jepen tekste, të një gjatësie rreth 300 fjalë ku përshkruhen episode narrative mbi fakte të renditura. Kandidatit i kërkohet të lexojë tekstin. Përmes një serie prej 5-6 pyetjesh për secilin tekst, kandidatit i kërkohen përgjigje bazuar vetëm në informacionin e dhënë në tekst e jo në njohuritë e mundshme apo paraprake të tij rreth problemit të parashtruar. Në këtë mënyrë, kontrollohet aftësia e kandidatit për t'u përqendruar, kuptuar e analizuar informacionin.

II. Test i kulturës së përgjithshme

Testi i kulturës së përgjithshme ka 25% të pyetjeve të paraqitura.

Në pjesën e testit të kulturës së përgjithshme do të kombinohen pyetje të ndryshme që do të arrijnë të nxjerrin në evidence sintezën e dijeve të kulturës së përgjithshme të marrë nga kandidati deri në atë moment. Fushat të cilat kontrollohen lidhen ngushtë si me aktualitetin politik, social e kulturor por edhe me koncepte e fenomene të së shkuarës.

Shembull 1

1-1. Identifikoni dyshen e saktë në listën e mëposhtme

- A) Universiteti Politeknik Tiranë - Bulevardi Dëshmorët e Kombit ☐
- B) Universiteti "Ismael Qemali" - Elbasan ☐
- C) Ministria e Punëve të Jashtme – Durrës ☐
- D) Kalaja e Argjirosë – Shkodër ☐

Shembull 2

1-2. Muzika e kolonës zanore që shoqëron himnin e BE-së është e kompozuar nga :

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| A) Ludwig van Beethoven | ☐ |
| B) Wolfgang Amadeus Mozart | ☐ |
| C) Fryderyk Chopin | ☐ |
| D) Giuseppe Verdi | ☐ |
| E) Richard Strauss | ☐ |

Shembull 3

1-3 Cili është autori i veprës së paraqitur më poshtë?

- | | |
|----------------------|--------------------------|
| A) Joan Miró | ☐ |
| B) Salvador Dalí | ☐ |
| C) Pablo Picasso | ☐ |
| D) Vassily Kandinsky | ☐ |
| E) René Magritte | ☐ |



III. Test i historisë dhe historisë së arkitekturës

Testi i historisë dhe historisë së arkitekturës ka 25% të pyetjeve të paraqitura.

Testi ka për qëllim përcaktimin e kriterëve të përgjithshme në përputhje me orientimin kronologjik në lidhje me protagonistët dhe fenomenet me rëndësi historike (të epokës së lashtë, të Mesjetës së hershme dhe të vonë, të epokës moderne, të epokës bashkëkohore). Këto udhëzime të përgjithshme historiko-kronologjike gjithashtu do të verifikohen nëpërmjet vlerësimit të njohurive të ndërthurura me ngjarje artistike specifike arkitekturore (vepra arkitekturore ose rryma artistike).

Në pjesën e testit të kulturës së historisë së përgjithshme do të kombinohen pyetje të ndryshme që do të arrijnë të nxjerrin në dukje sintezën e dijeve të marrë nga kandidati deri në atë moment.

Literatura në të cilën do të mbështetet testi do të bazohet në:

1. Tekstet shkollore të Historisë (*për shkollat e mesme*).
2. Tekstet shkollore të Historisë së Artit (*për shkollat e mesme*).

Pyetjet do të jenë të formuluar si pyetje të shkurtra që nuk kanë nevojë për zhvillim, por do të jenë me përzgjedhjen e alternativës së saktë.

Më poshtë, jepen shembuj të mënyrës se si ato mund të formulohen:

Shembull 1

1-1 Cila nga këto deklarata është e vërtetë?

- A) Muri i Berlinit u ndërtua në vitin 1961 për të parandaluar arratisjen e qytetarëve të Gjermanisë Lindore drejt Gjermanisë Perëndimore. ☐
- B) Muri i Berlinit u ndërtua në vitin 1950 pas bllokadës së Berlinit 1948-49. ☐
- C) Muri i Berlinit është ndërtuar në vitin 1956 pas revoltës hungareze. ☐
- D) Muri i Berlinit u ndërtua me iniciativën e Stalinit. ☐
- E) Muri i Berlinit u ndërtua në vitin 1962 pas krizës kubane. ☐

Shembull 2

1-2 Butrinti mban sot pasurinë më të madhe arkeologjike të vendit tonë.

Ai u ndërtua në periudhën:

- A) Rilindjes ☐
- B) Gotike ☐
- C) Greko-romake ☐
- D) Romanike ☐

Shembull 3

1-3 Cilët nga këto monumente NUK ju kujtojnë arkitekturën e perandorisë Romake:

- A) Koloseu ☐
- B) Harku i triumfit ☐
- C) Akueduktët ☐
- D) Katedralet ☐

IV. Test i komunikimit grafik

Testi i komunikimit grafik ka 25% të pyetjeve të paraqitura.

Testi synon të konstatojë aftësinë për të komunikuar grafikisht, për të analizuar grafikët, vizatimet dhe kushtet e korrespondencës në lidhje me objektin e përfaqësuar nga zotërimi i nocioneve elementare, që lidhen me komunikimin grafik dhe prezantimin (objektet, bimët, lartësitë, aksonometritë, etj.). Për të kryer këtë test, duhet të keni mjetet e vizatimit teknik.

Pyetjet do të bazohen në tekstin shkollor të teknologjisë. Në test do të kombinohen pyetje të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me:

1. KOMUNIKIMI GRAFIK DHE SKICAT

- Komunikimi grafik dhe lidhja e tij me teknologjinë.
- Skicat, materialet dhe veglat e skicimit e të vizatimit. Llojet kryesore të vijave.
- Skicimi i figurave të rrafshëta. Zmadhimi dhe zvogëlimi i tyre.
- Ndërtimet gjeometrike kryesore.
- Kalimet e rrjedhshme(rakordimet).
- Vizatimi i shkronjave dhe shifrave standarde në skica e vizatim teknik.

2. VIZATIMET ME PROJEKSIONE KËNDDREJTA

- Koncepti për pamjet dhe projektionet kënddrejta.
- Shkallët e vizatimit. Vendosja e përmasave.
- Skicat dhe vizatimet e detaleve.
- Leximi i vizatimeve të thjeshta dhe mesatare.

3. PARAQITJET ME PRERJE DHE AKSONOMETRIKE

- Prerjet, vijëzimet, emërtimet. Llojet e prerjeve.
- Projektionet aksonometrike. Dimetria dhe izometria.
- Paraqitja aksonometrike e figurave të rrafshëta dhe e trupave gjeometrikë.
- Hapja e sipërfaqeve të trupave gjeometrik.
- Hapja e prizmit dhe cilindrit të prerë pjerrtas.

4. VIZATIMET E NDËRTIMIT DHE ATO SKEMATIKE

- Njohuri mbi vizatimet e ndërtimit. Plani i përgjithshëm, planimetritë e shtëpive të banimit, elementët e ndërtesës.
- Pajisjet hidro-sanitare, shenjat konvencionale.
- Vizatimet konstruktive.
- Banesat moderne, mobilimi i tyre, etj.
- Skemat kinematike të telefonisë, citofonisë, antena e TV, etj.
- Rrjeti elektrik dhe hidro-sanitar në banesë. Simbolikat e përdorura.

Literatura në të cilën do të mbështetet testi, do të bazohet në tekstin e shkollës së mesme:

1. Teknologjia 12

Shembull 1

1. Në Fig. 1 zgjidhni një nga opsionet a,b,c,d që nuk përcakton paraqitjen e pikës.

- A) ☐
- B) ☐
- C) ☐
- D) ☐
- E) ☐






Figura 1

Shembull2

2. Skica në Fig. 2 tregon :

- a) Ndërtimin e trekëndëshit kënddrejtë ☐
- b) Ndërtimin e trekëndëshit brinjënjëshëm ☐
- c) Ndërtimin e trekëndëshit brinjëndryshëm ☐
- d) Ndërtimin e trekëndëshit dybrinjënjëshëm ☐




Figura2

Shembull 3

3. Skica në Fig. 3 tregon:

- Spiralen me tre qendra
- Spiralen me katër qendra
- Spiralen e Arkimedit


☐
☐
☐


Figura 3

Shembull 4

4. Zgjidhni një nga opsionet a,b,c,d që nuk përcakton paraqitjen e rrafshit:

- Me dy vijëdrejta paralele ndërmjet tyre
- Me dy vijëdrejta që ndërpriten
- Me dy vijëdrejta të kithëta
- Me një vijëdrejtë dhe një pikë jashtë saj

☐
☐
☐
☐

Shembull 5

5. Në Fig. 4, ndani me kompas e vizore në tre pjesë të barabarta këndin e shtrirë.



Figura 4